

VO kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 53924/00)

8 korrik 2004

kjo çështje kishte të bënte me problemin tepër të diskutuar në Evropë dhe në Shqipëri në kuadrin e së drejtës së jetës – jetën e fetusit

I. Faktet kryesore

1. Kërkesa e kësaj çështje është bërë nga një shtetase franceze, Znj. Thi-Nho Vo, e cila ka lindur më 1967 dhe jeton në Francë. Më 27 nëntor 1991, ajo shkoi në spitalin e përgjithshëm të Lionit për një vizitë mjekësore të programuar gjatë muajit të gjashtë të shtatzënisë. Në të njëjtën ditë një grua tjetër, Znj. Thi Thanh Van Vo duhet të hiqte një kontraceptiv në të njëjtin spital.

2. Për shkak të një ngatërrese që lindi si pasojë e faktit që dy gratë kishin të njëjtin mbiemër, mjeku që vizitoi kërkuesen shpoi membranën e saj amniotike duke e bërë abortin të pashmangshëm.

3. Pas një kallëzimi penal të kërkueses dhe të bashkëshortit të saj më 1991, mjeku u akuzua për veprën penale të plagosjes së kryer nga pakujdesia, akuzë që pastaj u ndryshua në vrasje nga pakujdesia. Më 3 qershor 1996 gjykata penale e Lionit vendosi se mjeku nuk ishte fajtor për këtë akuzë. Kërkuesja apeloi dhe më 13 mars 1997 gjykata e apelit të Lionit e prishi vendimin e gjykatës penale dhe e gjeti mjekun fajtor për vrasje nga pakujdesia duke e dënuar me gjashtë muaj burg me kusht dhe me një gjobë prej 10 000 frangash franceze. Më 30 qershor 1999, Gjykata e Kasacionit e prishi vendimin e apelit duke vendosur se faktet e çështjes nuk përbënin veprën e vrasjes nga pakujdesia. Në këtë mënyrë ajo refuzoi që ta konsideronte fetusin si një qenie njerëzore e cila gëzonte mbrojtje nga e drejta penale franceze.

II. Vendimi i Gjykatës

4. Duke u bazuar në nenin 2 të Konventës, kërkuesja ankohej për refuzimin e autoriteteve për ta klasifikuar humbjen e fëmijës së saj të palindur ende si vrasje nga pakujdesia. Ajo pretendonte se Franca ishte e detyruar që me ligj t'i konsideronte akte të tilla si vepra penale.

A. Në lidhje me nenin 2

5. Gjykata vlerësoi se përgjigja e pyetjes se kur fillon jeta i takon së drejtës së brendshme: së pari për shkak se ky problem nuk kishte gjetur përgjigje në shumicën e shteteve që kanë ratifikuar Konventën, dhe veçanërisht në Francë ku çështja ka qenë subjekt i një debati publik; dhe së dyti sepse nuk kishte një konsensus në nivel evropian në lidhje me përkufizimin shkencor dhe ligjor të fillimit të jetës. Duke pasur parasysh këto vlerësime, Gjykata u shpreh se nuk ishte as e dëshirueshme dhe as e mundur në këto kushte që t'i përgjigjej në mënyrë abstrakte çështjes nëse një fëmijë që nuk ka lindur

ende është një person për qëllimet e nenit 2 të Konventës.

6. Në këto rrethana Gjykata e vlerësoi të panevojshme që të shqyrtonte nëse fundi i papritur i shtatzënisë së kërkueses përfshihej në qëllimin e nenit 2, duke vlerësuar se, edhe po të prezumohej zbatueshmëria e kësaj dispozite në këtë rast, Franca nuk kishte dështuar në respektimin e kërkesave për ruajtjen e jetës në sferën e shëndetit publik. Fëmijët e palindur ende nuk ishin të privuar nga çdo mbrojtje në bazë të së drejtës Franceze. Përveç procesit penal që kërkuesja kishte nisur ndaj mjekut për plagosje nga pakujdesia, ajo mund të kishte nisur një padi për shpërblim dëmi në gjykatat administrative e cila mund të kishte pasur mundësi të mira suksesi. Një padi e tillë mund t'i kishte mundësuar kërkueses që të provonte neglizhencën profesionale të mjekut dhe të përfitonte shpërblim për dëmin e pësuar. Pra nuk kishte pasur nevojë të fillonte një proces penal.

7. Në këto kushte Gjykata vendosi se, edhe po të prezumohej se neni 2 gjente zbatim në këtë rast, nuk ka pasur shkelje të kësaj dispozite.